



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2661/2 prot

Datë 01.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-81378-09-26-2023 me objekt **“Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë (shkolla “Mustafa Gjestila” dhe shkolla “28 Nëntori”, Mat)”** me fond limit 7,587,574. leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KLAME” SHPK Nipt K2158003F
Rruga Gani Kryeiu, Nr23, Kati i dytë njësia Administrative nr 11, Kondër Kamez
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mat.
Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel”

Në datën 31.10.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3551 dhe me nr. 2661/2023 prot., datë 31.10.2023 e operatorit ekonomik “KAMLE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-81378-09-26-2023 me objekt “Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë (shkolla “Mustafa Gjestila” dhe shkolla “28 Nëntori”, Mat)” me fond limit 7,587,574. leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “KLAME” SHPK .

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “KLAME” SHPK në ankesën nr. 2661/2023 datë 31.10.2023, pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, për listën e mallrave/ materialeve (mobilerie) objekt prokurimi të kërkuar, nuk janë paraqitur dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera për këto materiale/ pajisje, me qëllim vërtetimin e pajtueshmërisë së materialeve të prodhuara (ofertuar) me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

Për këto arsye në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

.Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.11.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro